



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

**OBJEKTIVAT FORMUES DHE KARAKTERISTIKAT E PROGRAMIT**

**MASTER SHKENCOR NË SHKENCA INFERMIERORE**

**Profili kulturor dhe profesional i studimit në përfundim të programit mësimor**

Programi i studimit: MSH në Shkenca infermierore synon rritjen e kapaciteteve profesionale dhe didaktike në fushën e shkencave infermierore të avancuara, mendimit kritik dhe aftësive të studentëve të infermierisë të jenë të aftë të hyjnë në menaxhimin e një studimi në të fushës, si dhe përfshirjen e tyre në studime të bashkërenditura me kolegët pedagogë.

Profesioni i infermierit përbën një kompleks kompetencash (njohurish, shkathtësish, shprehish, qëndrimesh dhe vlerash) të individit, që shërben si parakusht për të kryer punë të kualifikuar në profesionin infermieror.

Këto aftësi fitohen nëpërmjet të mësuarit sistematik në një institucion arsimit apo formimit ose veprimtarisë në punë dhe përsoset nëpërmjet rritjes së kualifikimit.

Ai ka për objektiv të përgatisë infermierë me formim të avancuar për të ofruar jo vetëm kujdes shëndetsor të kualifikuar për individët në nevojë por dhe të ndihmojnë menaxherët e institucioneve të kujdesit shëndetsor me studime mbi tregun e punës, sëmundje dhe epidemiologjinë e tyre apo dhe në aspekte të ndryshme të kujdesit shëndetsor.

Në përfundim të programit të studimeve studentët do të marrin diplomën: **Master shkencor në Shkenca Infermierore**

**Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor.**

Nëpërmjet këtij masteri shkencor, studentët aftësohen të demonstrojnë mjeshtëritë në integrimin e koncepteve infermierore në disiplina të ndryshme si dhe aftësinë të zbatojnë njohuritë teknike për të zgjidhur një problem shëndetsor si dhe të ofrojnë ndihmesën e tyre duke u përfshirë në instancat drejtuese të institucioneve shëndetsore.

Gjithashtu i përgatit studentët të realizojnë ndërhyrje bazë të pacientët si dhe ndihmon në përmbushjen e detyrave bazë të kërkuara prej një infermieri profesionist duke aplikuar mendimin kritik në vendimarrje; aplikimin e metodave bashkëkohore në kujdesin infermieror.

Studentët do të aftësohen gjithashtu për të komunikuar në mënyrë profesionale edhe me publikun për teknikat e avancuara infermierore që aplikohen në sëmundje të ndryshme, duke fituar mjeshtëri dhe përvojë në komunikimin formal dhe informal me studentë, infermierë, mjekë dhe specialistë të kujdesit shëndetsor.

Ky master shkencor synon të plotësojë kërkesat në rritje të tregut të punës ndërkombëtar për specialistë në fushën e infermierisë së avancuar, si profesionistë të pavarur dhe në gjendje të marrin vendime të bazuara në njohuritë e përfituara në këtë nivel studimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

Nëpërmjet këtij formimi, studentët ridimensionojnë konceptet për infermierinë e avancuar si shkencë e integritetit të shkencave teorike bazë në funksion të shfrytëzimit të aparaturave dhe teknikave të avancuara infermirore jo vetëm për qëllime trajtimi, por edhe për shfrytëzimin e tyre në krijimin e bazave të sigurta shkencore, dhe aplikimin e këtyre teknikave direkt në kujdesin shëndetsor.

Në përfundim të këtij programi të ciklit të dytë të studimeve studentët do të kenë njohuri, vizion, aftësi dhe eksperiencë të mjaftueshme për të ofruar një kujdes infermieror me cilësi të lartë, bashkëkohor, të bazuar mbi gjykimin kritik të fakteve tek një spektër i gjerë pacientësh në shërbime të të gjitha fushave infermirore.

Duke përdorur një kombinim të mirë-balancuar të instruktiveve didaktike në auditor, seminareve për diskutimin e eksperiencës klinike dhe kompetencës klinike të avancuar në repartin e patologjisë, studentët e FSHP në këtë program mësojnë si të masterizojnë dhe integrojnë praktikën e tyre klinike me trajnimin në përmirësimin e cilësisë së shërbimit, leadershipin infermieror, kërkimin klinik, informatizimin infermieristik dhe politikat shëndetsore e sociale.

Kjo ekspertizë akademike bazohet në kompetencën profesionale të avancuar, klinike me cilësore, duke përgatitur jo vetëm infermierët të aftë që kërkohen në vend aktualisht, por edhe infermier që mund të jenë liderë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, që do të udhëheqin të ardhmen e infermieristikës, duke e rritur rolin e infermierit në shërbimin shëndetsor në përgjithësi.

### **Mundësitë për punësim**

Mbajtësi i kësaj diplome mund të punojë në profesion në:

- ✓ Kompanitë e kujdesit shëndetsor, spitale, qendra shëndetsore shtetërore dhe private, lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.
- ✓ Asistentë të pedagogëve në institucione të arsimit të lartë të fushës infermirore duke ofruar ekspertizën e tyre në profesionalitetin praktik dhe ndihmesën në zhvillimin akademik të studentëve të ardhshëm.
- ✓ Gati për tu punësuar në institucione të kujdesit shëndetsor brënda dhe jashtë vendit në pozicione drejtuese si KI dhe menaxherë të pavioneve spitalorë.